




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0072093/22-1 dt. 08.08.2022
Mitrovicë



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenin 40, paragrafi 2, pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); si dhe nenet 10, 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, dhe 77 paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 të Statutit të Komunës së Mitrovicës, nenet: 5 paragrafi 10, 11, dhe 15, të Rregullores Komunale Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 08.08.2022, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” z. Halil Kastrati; (Iniciativa Nr. 02-060/01-0051123/22-5 e miratuar me dt. 10.06.2022), iniciativë kjo e mbështetur nga Komisioni për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e titujve (me Rekomandim Nr. 02-060/01-0069735/22-2.2 29.07.2022), sjell këtë:

VENDIM

Për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi”, Z. Halil Kastrati

1. MIRATOHET propozimi për ndarjen e titullit “Qytetar Nderi” i Komunës së Mitrovicës së Jugut Z. Halil Kastrati, me motivacion:
 - 1.1 "Për kontribut të çmuar në ndihmë të familjeve në nevojë dhe përmirësimet infrastrukture në territorin e Komunës së Mitrovicës dhe më gjerë”.
2. Obligohet Kryetari i Komunës që në harmoni me nenin 5 dhe dispozitat tjera të Rregullores Komunale Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve dhe në harmoni me procedurat e parapara me protokoll të Komunës të organizojë ceremoninë e dhënies së titullit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.
4. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAP

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës



Kryesuesja e Kuvendit

Vesë BROJA